



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborri Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.664/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Rustem Thaçi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik GRAGJANSKA INICIATIVA SRPSKI OPSTANAK, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.664/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik GRAGJANSKA INICIATIVA SRPSKI OPSTANAK, me seli në Mitrovica e Veriut, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale 2021 të datës 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 18.10.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik GRAGJANSKA INICIATIVA SRPSKI OPSTANAK, me seli në Mitrovica e Veriut, në të cilën pretendon se në vendvotimin nr. 3805 / 08R, anëtarja e tyre në vendvotim, Zorica Arsenijević, u largua nga vendvotimi në orën 9 për shkak të vjedhjes masive të votave. Pas kësaj, votimi në atë vendvotimi vazhdoi, ndërsa zëvendësimi nuk është aktivizuar. Të njëjtit theksojnë se kur dolën rezultatet kuptuan se kishte parregullsi të mëdha, vjedhja ishte e madhe ndërsa votat e tyre anuloheshin në numërim. I njëjti kërkon që të i mundësohet qasje në kutit me vota dhe përputhshmëria me nënshkrimet në mënyrë që ti dëshmojnë pretendimet e tyre. Më tutje theksohet se anëtari i tyre në këtë vendvotim nuk e nënshkroi librin në të cilin shënohen votat, dhe nuk e nënshkroi librin me rezultatet përfundimtare.

Si dëshmitar ka paraqitur ka paraqitur emrat e anëtarëve të vendvotimit Zorica Arsenijević, dhe Dushan Milunović.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe nga hetimi i bërë gjeti se

pretendimi i parashtruesit të ankesës se në vendvotimin 3805B/08R ka pasur vjedhje masive të votave nuk mund ta konsideroj si të bazuar për faktin se në librin e shënimeve në këtë vendvotim nuk ka pasur ndonjë shënim- vërejtje apo ndonjë parregullsi tjetër të shënuar nga asnjë anëtarë apo vëzhgues i atij vendvotimi lidhur me vjedhje te votave dhe për parregullsi tjera për të cilat pretendon pala ankuese.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk janë vërtetuar ato të cilat janë theksuar në ankesë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj shkeljet e pretenduara, andaj ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.664/2021 më datën 20.10.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi